

VENDIM

Nr.533, date 1.8.2003

PER PJESEMARRJEN E SHTETASVE NE PARANDALIMIN DHE PERBALLIMIN E EMERGJENCEVE CIVILE

Ne mbështetje te nenit 100 te Kushtetutës, te neneve 26 dhe 35 te ligjit nr.8756, date 26.3.2001 "Për emergjencat civile" dhe te nenit 12 te ligjit nr.8927, date 25.7.2002 "Për prefektin", me propozimin e Ministrit te Pushtetit Vendor dhe te Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Prefekti i qarkut, nëpërmjet zyrave te gjendjeve civile ne bashki dhe komuna, siguron te dhëna dhe mban evidence për shtetasit ne territorin e qarkut, me moshe nga 18 deri ne 55 vjeç për gratë dhe deri ne 60 vjeç për burrat.
2. Prefekti i qarkut, nëpërmjet qendrave te rekrutim-mobilizimit ne qarqe, evidenton dhe siguron te dhëna për shtetasit, te cilët gjate shërbimit ushtarak janë specializuar ne shërbime te mbrojtjes civile, operacionet e kërkim-shpëtimit, repartet xheniere, mbrojtjen nga armët e shkatërrimit ne mase, mbrojtjen nga zjarri, shërbimin shëndetësor, si dhe specialitete te tjera te nevojshme për përballimin e emergjenceve civile.
3. Prefekti i qarkut, nëpërmjet drejtorive arsimore te rretheve, evidenton dhe siguron te dhëna për shtetasit, te cilët kane përfunduar arsimin e larte dhe janë specialiste te fushave përkatëse, si dhe planifikon përfshirjen e tyre ne procesin e planifikimit, parandalimit dhe përballimit te emergjenceve civile.
4. Ne rastet e emergjenceve civile, drejtuesi qendror i operacionit/drejtuesi i operacioneve ne nivel qarku, i kërkon prefektit te qarkut angazhimin, sipas nevojave te shtetasve te afte. Prefekti i qarkut, ne bashkërendim me kryetarin e bashkise/komunës, urdhëron aktivizimin e shtetasve dhe planifikon përfshirjen e tyre pranë strukturave operacionale, qe veprojnë për parandalimin dhe përballimin e emergjenceve civile ne territorin e qarkut.
5. Kryetari i bashkise/komunës, nëpërmjet zyrave te gjendjeve civile ne bashki dhe komune, siguron te dhëna dhe mban evidence për shtetasit ne territorin përkatës, me moshe nga 18 deri ne 55 vjeç për gratë dhe deri 60 vjeç për burrat.
6. Kryetari i bashkise/komunës, ne rastet e emergjenceve civile, me kërkesë te komisionit vendor te Emergjenceve Civile ne bashki/komune, drejtuesit te operacioneve ne nivel qarku, drejtuesit te operacioneve ne nivel bashkie/komune, ne bashkërendim me prefektin urdhëron angazhimin, sipas nevojës te shtetasve te ane ne territorin përkatës te bashkise/komunës dhe planifikon përfshirjen e tyre pranë strukturave vendore ose strukturave te tjera operacionale, qe veprojnë për parandalimin dhe përballimin e emergjenceve civile ne territorin e prekur nga fatkeqësia.

7. Kur shtetasi angazhohet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile mbi 8 ore ne dite dhe larg vendbanimit sipas rastit, prefekti i qarkut, kryetari i bashkise/komunës, ne bashkëpunim me strukturat operationale dhe shoqatat humanitare, ku shtetasi është angazhuar, e trajtojnë me ushqim dhe fjetje.

8. Asnjë drejtues operacioni nuk mund te detyroje shtetasin e angazhuar ne operacionet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, te ndërhyjë ne situata dhe vende ku rrezikohet jeta e shtetasit, si dhe ku/kur kërkohet kualifikim i veçante.

9. Ne çdo rast kur me urdhër te prefektit, kryetarit te bashkise/komunës, shtetasi angazhohet për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, atij i lëshohet dokument zyrtar, qe vërteton angazhimin e tij ne strukturën përkatëse.

10. Dokumenti zyrtar, qe vërteton pjesëmarrjen e shtetasit ne parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, detyron punëdhënësin, qofte ky dhe subjekt privat, te garantoje vendin e punës dhe pagesën e plote.

Ne rastet e aksidenteve, institucionet përkatëse plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për përfitim te pensionit te invaliditetit, sipas legjislacionit ne fuqi.

11. Për moszbatimin e urdhrat te prefektit te qarkut dhe te kryetarit te bashkise/komunës për pjesëmarrje te shtetasve ne përballimin e situatave emergjente, zbatohen dispozitat e akteve ligjore e nënligjore ne fuqi.

12. Prefekti i qarkut, ne bashkëpunim me qendrat e rekrutim-mobilizimit ne qarqe, me drejtuesit e reparteve te forcave te armatosura ne territorin e qarkut, me stacionin e PMNZSh-se dhe OJF-te, programon dhe realizon trajnimin e shtetasve për situatat e emergjencave civile.

13. Ngarkohen Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Mbrojtjes, prefektët e qarqet dhe kryetaret e bashkive/komunave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano